

## KONTRATE SHITJE-BLERJE KUOTASH

Ne Durrës, sot me datën 17 Maj 2022 (dymijë e njezetedy) palet e meposhtme rane dakort personalisht si me poshte:

### **I. PALA SHITËSE:**

**Z.ANXHELO SAKO**, atesia Hiqmet, lindur me 01.03.1994 ne Durrës, banues ne lagjen nr.2, rruga “Gjergj Komneni”, shtetas Shqiptar, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nepermjet kartes se identitetit leshuar nga autoriteti i shtetit shqiptar nr. J40301100K, i cili ne kete kontrate do te cilesohet *si pala shitesë*

### **II. PALA BLERËSE:**

**Z.LANDI SHAHINI**, atesia Skender, lindur me 23.05.1980 ne Durrës, banues ne lagjen nr.3 Rruga “Egnatia”, shtetas Shqiptar, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nepermjet kartes se identitetit leshuar nga autoriteti I shtetit shqiptar Nr. I00523077N, i cili ne kete kontrate do te cilesohet *si pala blerese*

### ***Kushtet e pergjithshme:***


Shoqeria “**GTACC**” **SHPK**, eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar ne Regjistrin Tregetar date 19.04.2016, me NIPT L61619505S me seli Lagjja 3, Rruga Egnatia, Qendra Monun, Kati i parë, Durrës, me aktivitet ne fushen Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të çdo lloj mallrash konsumi apo mallra industriale. Pikë servisi, tregtime shumicë dhe pakicë të makinave dhe pjesëve të tyre. Dhënie me qira e automjeteve të çdo lloji, etj.

Ushtrimi i cdo lloj veprimtarie te lejueshme nga ligji per person juridik dhe per formen juridike te shoqerise, sipas percaktimeve te Ekstraktit te Regjistrin Tregtar, leshuar nga QKB-ja.

Ortakesia eshte dhe pala shitesë **Z.ANXHELO SAKO** me Numer kuotash **1.00**, **Perqindja ne kapital ne 100.00 %**, me **Kontribut ne para 1’000’000.00 Leke**, percaktuar ne nenin 1 te kesaj kontrate.

Palet kane rene dakord paraprakisht per kalimin e titullit te pronesise mbi kuoten dhe kapitalin e shoqerise sipas percaktimeve qe do te behen ne kete Akt shit-blerje, per masen dhe menyren e kalimit te kuotave Pales Blerese.

Per sa me siper dhe bazuar ne nenin 73, te ligjit nr.9901 date 14.04.2008, ” Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar , nga ligji nr.129/2014, “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.9901, date 14.04.2008, ,”Per tregtaret dhe shoqerite tregtare te ndryshuar”, palet bien dakord si me poshte vijon:



**NENI 1**  
**BLERJA E KUOTAVE NE SHITJE**

Sipas kushteve dhe afateve te kesaj Kontrate, ne Daten e nenskrimit te saj, Pala Shitese **Z.ANXHELO SAKO** i shet nga totali i pjese se saj takuese, Numer kuotash 1.00, Perqindja ne kapital 100.00 %, me Kontribut ne para 1'000'00.00 Leke, Pales Blerese Z. Landi Shahini dhe pala blerese do te bleje nga pala shitese Z.Anxhelo Sako nr.pjese, Numer kuotash, si me poshte:

- Numer kuotave 1.00, Perqindja ne Kapital ne 100.00 %, me Kontributin ne para 1'000'000.00 Leke nga Shitesi i kuotes te kapitalit te shoqerise dhe cdo te drejte qe lidhet me to, te lira nga cdo Barre, me cmimin e blerjes dhe te pagueshme sipas menyres qe percaktohet po aty.

**NENI 2**  
**CMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESES**

Çmimi total i blerjes se kuotave ne shitje eshte 1'000'000.00 Leke (*njemilion leke*), shume e cila eshte likujduar totalisht .

**NENI 3**  
**DEKLARIMET DHE GARANCITE**

Pala shitese me ane te kesaj Kontrate deklarone dhe garantone ne lidhje me Shoqerine si dhe me transaksionin qe parashikohet ne kete Kontrate.

Pala shitese deklarone dhe garantone se shoqeria eshte krijuar dhe themeluar sipas ligjeve shqiptare, nuk eshte ne gjendje pa aftesi paguese, apo ne falimentim.


Pala shitese deklarone se jane ndjekur rregullisht, te gjitha aktet ligjore dhe/ose procedurat e tjera te parashikuara nga legjislacioni shqiptar qe duhet te ndermerren nga/ose per llogari te Shitesit dhe qe autorizojne Shitesin te lidhe dhe te zbatoje kete kontrate.

**NENI 4**  
**PRONESIA**

Pala shitese eshte pronar i vetem dhe i ligjshem i gjithe kuotave qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise.

Kuotat ne shitje jane te lira nga cdo Barre e cfaredo lloji dhe Shitesi ka te gjitha te drejtat, kompetencen dhe autorizimin e plote per t'i shitur, per t'i kaluar apo transferuar dhe dorezuar kuotat ne shitje ne perputhje me afatet e Kontrates.

Nuk ka asnje Kontrate, marreveshje apo detyrim qe krijon apo vendos barre ne lidhje me kuotat ne shitje, ose ndonje numer kuotash te autorizuar por te pa emetuar ne kapitalin e Shoqerise. Asnje person nuk pretendon se ka te drejte mbi ndonje barre te mundshme te lidhur me kuotat qe jane ne shitje.



**NENI 5**  
**MENYRA E KALIMIT TE PRONESISE SE KUOTAVE**

Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, pala shitese e humbet te drejten e pronesise mbi **Numer kuotash 1.00, Perqindja ne kapital ne 100.00%, me Kontributin ne para 1'000'000.00 Leke.**

Ortaku i Shoqerise Z.ANXHELO SAKO humbet pronesine ne masen Numer kuotash 1.00, Perqindja ne kapital ne 100.00 %, me Kontributin ne para 1'000'000.00 Leke, te Kapitalit themeltar te shoqerise "GTACC" SHPK, duke kaluar te drejten e pronesise te Bleresit ortake, si me poshte:

Z. Landi Shahini, i cili behet ortake ne masen Numer kuotash 1.00, Perqindja ne kapital ne 100.00 %, me Kontributin ne para 1'000'000.00 Leke.

**NENI 6**  
**PREMTIME TE PERBASHKETA TE PALEVE**

Palet do t'i sigurojne njera-tjetres, cdo dhe gjithë informacionin e nevojshem per perfundimin e ketij procesi

**NENI 7**  
**LIGJI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI**

Kjo kontrate rregullohet nga ligji shqiptar.

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin ndermjet paleve ne lidhje me kete Kontrate do te zgjidhen me mirekuptim, ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres.

**NENI 8**  
**TE NDRYSHME**

**8.1 Ndryshimet**

Cdo korigjim, ndryshim, zgjidhje apo heqje dore nga ndonje prej dispozitave te kesaj Kontrate, do te jete e vlefshme vetem ne qofte se behet me shkrim dhe nenshkruhet nga ose per llogari te seciles Pale.

**8.2 Vlefshmeria e pavarur nga njera tjetra e dispozitave kontraktore**


Ne rast se nje dispozite ose detyrim sipas kesaj Kontrate eshte i pavlefshem, i pa ligjshem, ose i pa zbatueshem ne nje juridiksion, vlefshmeria ligjshmeria dhe zbatueshmeria e dispozitave ose detyrimeve ne nje juridiksion tjetër, nuk do te preket ose cenohet nga nje fakt i tille.

Palet pranojne se do te perpiqen te zevendesojne nje dispozite te pavlefshme ose te pa zbatueshme ne masen me te madhe te mundshme, per te permbushur qellimin e kesaj dispozite.

**8.3 Njoftimet**

Njoftimet ose komunikimet e tjera sipas ose ne lidhje me kete Kontrate (Njoftimi) do te jene :

- Me shkrim



- Ne gjuhen shqipe
- Do te dorezohen ose dergohen me poste te shpejte me kthim pergjigje ose faks, pales qe duhet te marre njoftimin ne adresen e caktuar nga pala perkatese.

Me perjashtim te rastit kur provohet se njoftimi eshte marre me shpejt, njoftimi do quhet i dhe ne nese:

- Eshte derguar me poste, 10 dite pune, pas postimit te tij
- Eshte derguar me faks, kur konfirmimi I dergimit te tij eshte regjistruar nga faksi i derguesit.

#### **8.4 Kalimi i te drejtave**

Kjo Kontrate eshte detyrim ligjor dhe ne perfitim te paleve, trashegimtareve te tyre dhe personave te cileve u kalojne keto te drejta.

Bleresit nuk mund te kalojne dhe transferojne te drejtat e tyre sipas kesaj Kontrate, plotesisht apo pjeserisht, pa miratimin paraprak me shkrim te Shitesit, miratim i cili nuk do te refuzohet pa arsye.

#### **8.5 Kostot dhe taksat**


Pavec kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, secila pale do te paguaje shpenzimet e saj ne lidhje me negocimin, hartimin, nenshkrimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate dhe te shtojcave te saj (nese do te kete). Te gjitha shpenzimet noteriale per nenshkrimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate do te paguhen nga pala blerese.

#### **8.6 Teresia e Kontrates**


Kjo Kontrate perben marreveshjen e plote dhe zevendeson cdo marreveshje te meparshme midis paleve qe lidhet me objektin e kesaj Kontrate.

Palet kishin rene dakord paraprakisht dhe me vullnetin e tyre te lire dhe te plote per lidhjen e kesaj Kontrate.

*Pala shitese*

Anxhelo Sela  


*Pala blerese*

Leandri Shalini  


**V E N D I M**

**I ORTAKUT TE SHOQERISE " GTACC "**

Ne Durres, sot me daten 17.05.2022, ne ambjentet e Selise se Shoqerise, nen thirrjen e Ortakut te Vetem, mbahet mbledhja e Asamblese se Ortakut

Eshte prezent :

1. Z.Anxhelo Sako, zoterues i kuotes 100% te kapitalit

Mbledhjen e kryeson ortaku Z. Anxhelo Sako i cili:  
e deklaroi mbledhjen te hapur me kete;

Rend Dite: 1. Shitja e kuotes te kapitalit te shoqerise.

Fillon shqyrtimi i problemeve te Rendit te dites...

**Flet ortaku Z. Anxhelo Sako, i cili thote :**

Lidhur me ceshtjen Rend Dite;

Megjenese ortaku i vetem ka ndryshuar interesat e tij te biznesit, eshte dakort qe te shese kuoten e saj ne pjesmarrjen e kapitalit te shoqerise e cila ka nje vlere nominale 1'000'000 leke.

Si perfundim,


**V E N D O S I :**

1. Te miratoje shitjen e kuotes te kapitalit prej 1.00 kuote, ne perqindje 100.00 dhe vlere 1'000'000.00 leke.
2. Vlora e shitjes se kuotes te Kapitalit te jete ne 1'000'000.00 leke.
3. Miratimin e shitjes se kuotes tek pala blerese Z. Landi Shahini, nga pala shitesese Z.Anxhelo Sako te 1.00 kuote, ne perqindje 100.00 dhe vlere 1'000'000.00:

Me pas mbledhja deklarohet e mbyllur.

Ortaku

Anxhelo Sako

Anxhelo Sako  


V E N D I M

I ORTAKUT TE TREGTARIT TE REGJISTRUAR " GTACC "

Ne Durres, sot me daten 17.05.2022, ne ambjentet e Selise se Tregtarit te regjistruar, nen thirrjen e Tregtarit, mbahet mbledhja e Tregtarit te Regjistruar

Eshte prezent ORTAKU:

1. Z.Landi Shahini, zoterues i kuotes 100% te kapitalit

Mbledhjen e kryeson ortaku Z.Landi Shahini  
Ortaku e deklaroi mbledhjen te hapur me kete;

**Rend Dite:** 1. Ndryshimi i Administratorit.

Fillon shqyrtimi i problemeve te Rendit te dites.

Flet Ortaku Z.Landi Shahini, i cili thote :

Lidhur me ceshtjen Rend Dite;

Per shkak te ndryshimit ne pronesine e kuotave te shoqerise, mblidhet asambleja e ortakut te shoqerise per emerimin e administratorit te ri. Une propozoj shkarkimin e Administratorit Z.Anxhelo Sako dhe emerimin e administratori i ri te jete Z.Landi Shahini dhe afati i emerimit te jete per periudhen 17 Maj 2022 – 17 Maj 2027.

Si perfundim, Ortaku i Shoqerise

**V E N D O S I :**

1. Te shkarkohet administratori i shoqerise Z.Anxhelo Sako.
2. Te emeroje si administrator te shoqerise Z.Landi Shahini.
3. Afati i mandatit te administratorit te jete 17 Maj 2022 – 17 Maj 2027.
4. Te depozitohet ky Vendim i asamblese prane "QKB" nga administratori Z.Landi Shahini me Karte Identiteti nr.personal I00523077N.

Mbledhja e shoqerise deklarohet e mbyllur.

Ortaku  
*Landi Shahini*  
*[Signature]*